



MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E KURRIKULËS DHE E KUALIFIKIMIT

MODELE TESTESH PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

(Teste të hartuara nga mësuesit)

LËNDA “GJEOGRAFI”



TETOR, 2019

Arsimi i mesëm i ulët

Klasat 6 - 9

Klasa: 6-të

Përgatiti: Selvi Dyrmishi, mësuese

Periudha e parë

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Konceptet	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit Nxënësi:	Niveli II i arritjes së kompetencave 40%	Niveli III i arritjes së kompetencave 40%	Niveli IV i arritjes së kompetencave 20%
Gjeografia dhe konceptet bazë të kërkimit gjeografik: vendi, mjedisi, rajoni.	2 pikë 7%	demonstron përmes shembujve konceptet që përdorin gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre;	2 pikë	-	-
Kërkimi gjeografik: metodat dhe mjetet gjeografike.	6 pikë 20%	përshkruan metodat shkencore të kërkimit gjeografik;	4 pikë	1 pikë	1 pikë
Gjeografi dhe roli i tij në studimin e dukurive gjeografike.	4 pikë 13%	diskuton mbi rolin e gjeografit në studimin e dukurive fizike dhe humane gjeografike; diferencon ngjarje të rëndësishme të historisë së zhvillimit gjeografik;	1 pikë	2 pikë	1 pikë

Paraqitja grafike e Tokës: Harta, plani, globi, dallimet dhe ngjashmëritë mes tyre.	4 pikë 13%	krahason hartën, planin dhe globin duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre;	-	3 pikë	1 pikë
Hartat gjeografike, llojet e hartave dhe përdorimi i tyre.	7 pikë 24%	dallon lloje të ndryshme të hartave gjeografike dhe përdorimet e tyre; shpjegon legjendën e një harte gjeografike;	4 pikë	3 pikë	-
Vendndodhja gjeografike: absolute dhe relative.	6 pikë 20%	mat distanca në vijë ajrore dhe distanca rrugore në harta me shkallë zvogëlimi të ndryshme; përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike;	-	2 pikë	4 pikë
Harta e Shqipërisë: Shqipëria në Ballkan.	1 pikë 3%	dallon vendndodhjen gjeografike (relative) të Shqipërisë në hartën e Ballkanit.	1 pikë	-	-

TEST

Rrethoni alternativën e saktë.

1. Kontinenti i Amerikës u zbulua nga:

1 pikë

- A) Vasko De Gama
- B) Bartolomeo Diaz
- C) Kristofor Kolombi
- D) Ferdinand Magelani

2. Në veriperëndim dhe veri, Republika e Shqipërisë kufizohet me:

1 pikë

- A) Kosovën
- B) Malin e Zi
- C) Maqedoninë e Veriut
- D) Greqinë

3. Është pjesë e karakteristikave fizike të një vendi:

1 pikë

- A) Gjuha
- B) Vallet popullore
- C) Relievi
- D) Njerëzit e shquar

4. Listoni tri ndër mjetet që përdorin gjeografët. Shpjegoni rëndësinë e njërit prej tyre:

4 pikë

a)

b)

c)

.....

.....

5. Rrethoni V nëse pohimi është i saktë ose G nëse pohimi është i gabuar:

4 pikë

a) Rajoni është një grupim vendesh me karakteristika të njëjta ose të ngjashme. V / G

b) Lidhja e njeriut me mjedisin sjell gjithmonë rezultate të mira. V / G

c) Numërimi i nxënësve të një shkolle ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave. V / G

d) Palestra e shkollës paraqet një hapësirë të hapur. V / G

6. Lidhni me shigjetë llojin e hartës me degën e Gjeografisë në të cilën ajo përdoret më së shumti:

4 pikë

a) Hartë që paraqet relievin, hidrografinë, bimësinë, tokat Gjeografia e popullsisë

b) Hartë që paraqet ndarjen administrative dhe kufijtë e shteteve Gjeografia ekonomike


c) Hartë e mineraleve Gjeografia fizike

d) Hartë demografike Gjeografia politike

7. Më poshtë është paraqitur një hartë fiziko-gjeografike e Shqipërisë. Identifikoni në hartë këto elemente:


4 pikë

- a) Shkallën e hartës, duke e shënuar me shkronjën A.
- b) Legjendën e hartës, duke e shënuar me shkronjën B.
- c) Një nga zonat që paraqet lartësinë mbi 2000 m, duke e shënuar me shkronjën C.
- d) Një nga zonat që është në nivelin e detit, duke e shënuar me shkronjë D.



8. Në orën e gjeografisë mësuesja solli në klasë planin e një kopshti dhe hartën e cila tregonte vendndodhjen e atij kopshti. Mësuesja kërkoi nga nxënësit që të gjenin të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre. Identifikoni dhe ju tre tipare të përbashkëta të planit dhe hartës, dhe nga një tipar të veçantë për secilën.

5 pikë




9. Përcaktoni koordinatat gjeografike në situatat e mëposhtme:

4 pikë

Situata 1: Irma dhe Ledia kanë vendosur të realizojnë një udhëtim në një nga vendet e Hemisferës Jugore. Përcaktoni në hartë në cilën pikë do të udhëtojnë vajzat dhe koordinatat gjeografike të kësaj pike?

Situata 2: Albani ka vëzhguar hartën e botës dhe ka lokalizuar në të oqeanin më të madh të rruzullit tokësor. Gjeni në hartë pikën që tregon këtë oqean dhe përcaktoni koordinatat gjeografike të kësaj pike?



10. Gjatë këtij viti shkollor, Sara, një nxënëse e klasës së gjashtë ka marrë shumë njohuri në lëndën e historisë për qytetërimet e lashta. Më shumë i ka bërë përshtypje Perandoria Romake. Për këtë arsye Sara dhe familja e saj do të udhëtojnë për në Romë. Ata kanë llogaritur që nëse udhëtojnë me makinë distanca Tiranë-Romë është 760 km. Referuar situatës së mësipërme, përcaktoni në hartën me shkallë zvogëlimi 1:125 000, distancën në vijë ajrore midis Tiranës dhe Romës.

2 pikë



Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-30

Klasa: 7-të

Përgatiti: Asuela Bega, mësuese

Periudha e dytë


Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Konceptet	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit Nxënësi:	Niveli II i arritjes së kompetencave 40%	Niveli III i arritjes së kompetencave 40%	Niveli IV i arritjes së kompetencave 20%
Hidrosfera Ujërat e oqeaneve dhe deteve, veçoritë e tyre. Lëvizjet e ujit të oqeaneve dhe deteve.	10 pikë 33%	identifikon veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve (temperatura, kripësia, dendësia); bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeaneve dhe deteve dhe faktorëve që ndikojnë: - valët detare - rrymat oqeanike - baticat dhe zbaticat; skicon në hartë drejtimin e lëvizjes dhe rrugën që ndjekin disa nga rrymat oqeanike dhe përshkruan rolin e tyre në klimën e rajoneve që përshkojnë;	4 pikë	5 pikë	1 pikë
Lumenjtë, tipet e lumenjve dhe veprimtaria e ujërave rrjedhës.	5 pikë 17%	identifikon, bazuar në vëzhgime dhe në modele të ndryshme, elementët përbërës të lumit dhe llojet e lumenjve; identifikon disa nga pasojat dhe format e relievit që krijohen nga veprimtaria gërryese, transportuese dhe depozituese në	3 pikë	-	2 pikë

		brigjet detare , e ujërave rrjedhës dhe karstit;			
Veprimi i borës dhe i akujve.	4 pikë 13%	përshkruan formimin e borës dhe akujve dhe veprimin e tyre në mjedis;	1 pikë	2 pikë	1 pikë
Litosfera Shkëmbinjtë, llojet e tyre.	11 pikë 37%	modelon ndërtimin e brendshëm të tokës duke përshkruar veçoritë kryesore për secilën shtresë; klasifikon shkëmbinjtë sedimentarë, metamorfikë dhe vullkanikë.	4 pikë	5 pikë	2 pikë

TEST

Për t'ju përgjigjur pyetjeve 1 dhe 2, referojuni hartës nr. 1, e cila tregon shpërndarjen e kripësisë së ujërave oqeanike. Kripësia e këtyre ujërave ndryshon nga ekuatori në drejtim të poleve.



Harta nr.1

1. Bazuar te harta nr. 1, kripësia më e madhe e ujërave të oqeaneve është në gjerësitë gjeografike:

1 pikë

- A) polare
- B) tropikale

- C) mesatare
- D) ekuatoriale



2. Pasi të keni zgjedhur alternativën e saktë për pyetjen 1, jepni dy arsye pse kripësia e ujërave është më e lartë në atë gjerësi gjeografike.

2 pikë

Dy faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e baticave dhe zbatcave janë forca tërheqëse e Hënës dhe e Diellit. Figurat 1 dhe 2 paraqesin pozicione të ndryshme të Tokës dhe Hënës në raport me Diellin gjatë formimit të baticave dhe zbatcave.

3. Shpjegoni ndryshimin në formimin e baticave midis figurës 1 dhe figurës 2.

2 pikë





4. Sa batica dhe zbatca ndodhin gjatë 24 orëve?

1 pikë

- A) 1 baticë dhe 1 zbaticë

- B) 2 batica dhe 2 zbatica
- C) 3 batica dhe 2 zbatica
- D) 4 batica dhe 2 zbatica

Harta nr. 3 tregon lëvizjen e erërave të qarkullimit të përgjithshëm, ndërsa harta nr. 4 tregon lëvizjen e rrymave oqeanike. Vëzhgoni me kujdes të dyja hartat dhe përgjigjuni pyetjeve nga 5 -8.



5. Çfarë vini re në lidhje me drejtimin e erërave të qarkullimit të përgjithshëm dhe rrymave oqeanike? **1 pikë**
6. Cili është faktori kryesor që ndikon në formimin e rrymave oqeanike? **1 pikë**
- A) Erërat e qarkullimit të përgjithshëm

- B) Erërat lokale
- C) Efekti i Koriolosit
- D) Forma e brigjeve të kontinenteve

7. Drejtimi i rrymave oqeanike të ngrohta është nga:

1 pikë

- A) meridiani fillestar drejt meridianit të ndërrimit të datave.
- B) meridiani i ndërrimit të datave drejt meridianit fillestar.
- C) ekuatori në drejtim të poleve.
- D) polet drejt ekuatorit.

8. Çfarë ndodh me drejtimin e rrymave oqeanike kur përplasen më një masë tokësore si për shembull me një kontinent.

1 pikë

Në figurë tregohet rruga që ndjek një lumë në të gjithë gjatësinë e tij.


9. Përcaktoni në figurë:

3 pikë

- Degët e lumit
- Grykëderdhjen e lumit
- Një nga meandret e lumit

10. Në cilën rrjedhë të lumit mbizotëron më shumë veprimtaria gërryese?

1 pikë



Në cilën rrjedhë të lumit mbizotëron më shumë veprimtaria grumbulluese?


1 pikë


Për t'ju përgjigjur pyetjeve nga 11 dhe 13 referojuni figurës 1, 2 dhe grafikut.

Në malet e larta dhe në zonat polare, për shkak të temperaturave të ulëta, reshjet bien në formën e borës. Kur sasia e borës që bie është më e madhe së sasia e borës që shkrin, formohet bora e përhershme. Lartësia e kufirit të borës së përhershme ndryshon nga ekuatori në pole.

Në rastet kur trashësia e borës është shumë e madhe, ajo shndërrohet në akull e më pas në akullnajë.

Figurat 1 dhe 2 tregojnë dy tipat e akullnajave, ndërsa grafiku tregon lartësinë (m) të kufirit të borës së përhershme.





11. Bazuar në grafikun e dhënë, kufiri i borës së përhershme është më i ulët në zonat me gjerësi:

1 pikë

- A) polare
- B) mesatare
- C) tropikale
- D) ekuatoriale

12. Emërtoni dy tipat e akullnajave që tregohen në figurën 1 dhe 2.

2 pikë


Figura 1: _____

Figura 2: _____

13. Shkruani ndryshimin kryesor midis dy tipeve të akullnajave që tregohen në figurën 1 dhe 2.

1 pikë

Figura tregon ndërtimin e brendshëm të Tokës.



14. Bazuar në figurën e mësipërme, identifikoni ndryshimin midis kores oqeanike dhe kores kontinentale.

1 pikë

15. Ku gjendet astenosfera dhe në çfarë gjendje është ajo?

2 pikë

16. Mineralet që mbizotërojnë në bërthamë janë:

1 pikë

- A) Hekuri dhe nikeli
- B) Hekuri dhe alumini
- C) Hekuri dhe silici
- D) Hekuri dhe bakri

Figura 1 paraqet ciklin e shkëmbit. Numrat nga 1-5 tregojnë fazat e ndryshimit të shkëmbinjve.

17. Bazuar në figurën 1 shpjegoni se si formohen tre llojet kryesorë të shkëmbinjve të paraqitur në figurë.

3 pikë



Figura 1

Figura 2 tregon llojet e shkëmbinjve magmatikë në varësi të vendit të formimit.

18. Si formohen shkëmbinjtë magmatikë intruzivë dhe efuzivë?

2 pikë



Figura 2

19. Bazuar në figurën 2, identifikoni një ndryshim midis këtyre dy lloj shkëmbinjve.

1 pikë

20. Emërtoni një lloj shkëmbi metamorfik që përdoret gjerësisht në ndërtim.

1 pikë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-30

Klasa: 8-të

Përgatiti: Selvi Dyrmishi, mësuese

Periudha e parë

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Konceptet	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II i arritjes së kompetencave 40%	Niveli III i arritjes së kompetencave 40%	Niveli IV i arritjes së kompetencave 20%
Shpërndarja e popullsisë në botë.	4 pikë 13%	Nxënësi: lokalizon në hartë dhe interpreton rajonet me dendësinë më të madhe dhe më të vogël të popullsisë;	1 pikë	2 pikë	1 pikë
Shpërndarja hapësinore e gjuhëve.	3 pikë 10%	prezanton dhe komunikon shpërndarjen hapësinore të gjuhëve në botë;	-	3 pikë	-
Vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim.	1 pikë 3%	bën dallimin ndërmjet tipareve të rajoneve të zhvilluar dhe atyre në zhvillim përmes shembujve tipikë;	1 pikë	-	-
Evropa, pozita gjeografike dhe veçoritë kryesore fiziko-gjeografike.	4 pikë 13%	identifikon dhe interpreton në hartë njësitë e mëdha fiziko-gjeografike të Evropës;	2 pikë	-	2 pikë
Popullsia e Evropës dhe dinamika e saj.	5 pikë 18%	analizon të dhëna dhe nxjerr përfundime për dinamikën e popullsisë së Evropës;	5 pikë	-	-

Tipare të përgjithshme të zhvillimit ekonomik të hapësirës evropiane.	3 pikë 10%	sjell fakte dhe të dhëna që dëshmojnë larminë e zhvillimit ekonomik të hapësirës evropiane;	-	3 pikë	-
Rajonet kryesore të Evropës, veçoritë e tyre kryesore fiziko-gjeografike dhe humane.	6 pikë 20%	identifikon ngjashmëritë dhe dallimet në veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajoneve të Evropës; përdor hartat për të interpretuar veçoritë e secilit rajon të Evropës;	1 pikë	3 pikë	2 pikë
Bashkimi Evropian nga perspektiva gjeografike.	4 pikë 13%	përshkruan historinë e formimit, zhvillimit, e zgjerimit të Bashkimit Evropian.	1 pikë	1 pikë	2 pikë

TEST

Rrethoni alternativën e saktë.

1. Shpërndarja e popullsisë në botë është ndikuar:

1 pikë

- A) vetëm nga faktorë fizikë.
- B) vetëm nga faktorë mjedisorë.
- C) vetëm nga faktorë ekonomikë.
- D) nga të gjithë faktorët e mësipërm.

2. Hapësirat më të populluara të rruzullit tokësor ndodhen në:

1 pikë

- A) zonën e klimës mesatare të hemisferës veriore.
- B) zonën e klimës mesatare të hemisferës jugore.
- C) zonën përreth ekuatorit.
- D) zonën përreth tropikëve.

3. Dukuria tipike e popullsisë në vendet e zhvilluara të Evropës është:

1 pikë

- A) lindshmëria e lartë.
- B) plakja e popullsisë.
- C) mbipopullimi.
- D) braktisja.

4. Praga është një nga qytetet më të rëndësishme të rajonit të:

1 pikë

- A) Evropës Perëndimore.
- B) Evropës Lindore.
- C) Evropës Mesdhetare.
- D) Evropës Ishullore.

5. Cili nga këto shtete u anëtarësua në Bashkimin Evropian në vitin 1995?

1 pikë

- A) Austria
- B) Danimarka
- C) Sllovenia
- D) Portugalia

6. Nga viti 2010 deri në 2016, volumi i prodhimit industrial në Bashkimin Evropian është rritur me 5.6%. Megjithatë, diferencat mes sektorëve të ndryshëm, sipas të dhënave të ofruara nga ‘Eurostat’ janë të dukshme dhe në to reflektohen qartë kërkesat e tregut dhe prioritet e BE në industri. Listoni tri degët më të rëndësishme të industrisë përpunuese në Evropë:

3 pikë

- a)
- b).....
- c).....

7. Cila nga etapat e krijimit të BE-së konsiderohet si “prova gjenerale”?

3 pikë

.....

Tregoni dy arsye pse u konsiderua si “prova gjenerale”:

- a)

b)

8. Rrethoni V nëse pohimi është i saktë dhe G nëse pohimi është i gabuar:

4 pikë

- A) Gjuha shqipe formon një degë të veçantë në familjen e gjuhëve indoevropiane. V / G
- B) Gjuhët e grupit roman quhen ndryshe gjuhë neolatine. V / G
- C) Gjuha suedeze është pjesë e grupit të gjuhëve sllave. V / G
- D) Gjuha baske është pjesë e grupit të gjuhëve romane. V / G

9. Përcaktoni në cilin rajon të Evropës ndodhen njësitë e mëposhtme:

3 pikë

- a) Gadishulli i Krimesë.....
- b) Vullkani Vezuv.....
- c) Alpet Dinarike.....

10. Jona dhe familja e saj kanë emigruar nga Shqipëria për në Angli. Fillimi për ta ishte shumë i vështirë por me kalimin e viteve ata u përshtatën me jetesën në Angli dhe tashmë ndjehen shumë mirë.

Bazuar në situatën e mësipërme, evidentoni dy ndër pasojat pozitive dhe negative që ka sjellë lëvizja migratore për këtë familje.

4 pikë

Pasoja pozitive	Pasoja negative

--	--


11. Kontinenti i Evropës dallohet për larminë e formave të relievit. Nëse do të planifikoni të ndërmerri një udhëtim nëpër Evropë, emërtoni në hartën e mëposhtme katër njësi të relievit të cilat do të dëshironit t'i vizitoni:

4 pikë



12. Entela, një nxënëse e klasës së shtatë, së bashku me familjen vizituan katër shtete evropiane: Spanjën, Irlandën, Suedinë dhe Hungarinë. Ky udhëtim e ndihmoi Entelën të mësonte më shumë për këto shtete dhe vendndodhjen e tyre. Entela u tregoi shoqëve të klasës për udhëtimin e saj dhe së bashku zhvilluan një kuiz se kush e gjente më shpejt në hartë vendndodhjen e këtyre shteteve dhe rajonin të cilit i përket. Përcaktoni dhe ju, në hartën politike të Evropës këto shtete dhe rajonin ku ato bëjnë pjesë.

4 pikë



Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-30

Klasa: 9-të

Përgatiti: Asuela Bega, mësuese

Periudha e dytë

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Konceptet	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II i arritjes së kompetencave 40%	Niveli III i arritjes së kompetencave 40%	Niveli IV i arritjes së kompetencave 20%
Karakteristikat kryesore të liqeneve. Tiparet kryesore të lumenjve dhe burimeve ujore.	13 pikë 43%	Nxënësi: përshkruan karakteristikat kryesore të liqeneve të Shqipërisë; identifikon tiparet e lumenjve dhe burimeve ujore në Shqipëri; ndërton dhe interpreton grafikët e regjimit të rrjedhjes së lumenjve kryesorë; interpreton në hartë shpërndarjen e rrjetit hidrografik të Republikës së Shqipërisë;	5 pikë	5 pikë	3 pikë
Tokat, llojet dhe rëndësia e tyre për zhvillimin	4 pikë 13 %	përshkruan tokat, llojet e tyre dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin ekonomik të vendit;	1 pikë	2 pikë	1 pikë

ekonomik të vendit.		interpretton shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në degradimin dhe shkretëzimin e tokave, dhe parashikon rrugë të mbrojtjes së tyre;			
Organizimi administrativ i Shqipërisë dhe faktorët që kanë ndikuar.	1 pikë 3 %	krahason skema të organizimit administrativ të Shqipërisë përgjatë periudhave të ndryshme dhe vlerëson faktorët që kanë ndikuar;	1 pikë	-	-
Popullimi i hershëm dhe ecuria e numrit të popullsisë. Veçori të shpërndarjes gjeografike të popullsisë në Shqipëri. Shtimi natyror i popullsisë në Shqipëri dhe ecuria e tij.	9 pikë 30 %	interpretton veçori të shpërndarjes gjeografike të popullsisë në Shqipëri; identifikon veçori të strukturës së popullsisë (moshore, gjinore, fetare, etnike, sipas vendbanimeve); ndërton dhe interpretton grafikë, diagrama për strukturën e popullsisë dhe harta të shpërndarjes gjeografike të saj; identifikon faktorët dhe pasojat e migrimeve të popullsisë në etapat	2 pikë	5 pikë	2 pikë

<p>Strukturat e popullsisë (moshore, gjinore, fetare, etnike, sipas vendbanimeve) dhe shpërndarja gjeografike e tyre.</p> <p>Migrimet e popullsisë shqiptare në periudha të ndryshme.</p>		<p>më të rëndësishme historike;</p>			
<p>Karakteristikat e zhvillimit ekonomik në periudha të ndryshme.</p>	<p>3 pikë 10 %</p>	<p>identifikon tipare të zhvillimit ekonomik përgjatë periudhave të ndryshme të zhvillimit;</p>	<p>3 pikë</p>	<p>-</p>	<p>-</p>

TEST

Shqipëria dallohet për hidrografi të pasur dhe një rrjet të dendur lumor. Shumica e lumenjve burojnë nga zonat e larta malore.

Referuar hartës së dhënë dhe grafikut përgjigjuni pyetjeve nga 1-5.

1. Vendosni në hartën e Shqipërisë shkronjat që i korrespondojnë elementeve hidrografike të mëposhtme:

4 pikë

Me shkronjën A shënoni rrjedhën e poshtme të lumit Shkumbin

Me shkronjën B shënoni Liqenin e Prespës së Madhe

Me shkronjën C shënoni Lagunën e Nartës

Me shkronjën D shënoni Lumin Devoll



1 pikë

2. Lumi më i gjatë i Shqipërisë është:

A) Shkumbini

B) Semani

C) Vjosa

D) Drini

3. Lumi Drino është një nga degët e lumit:

A) Shkumbin

B) Valbona

C) Vjosa

D) Drin


1 pikë

4. Cili është i vetmi lum fushor në vendin tonë?

1 pikë

- A) Buna
- B) Mati
- C) Erzeni
- D) Ishmi

Grafiku tregon prurjet për lumin Valbona. Bazuar në të dhënat e grafikut, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:



5. Në cilin muaj janë regjistruar prurjet më të mëdha për lumin Valbona? Jepni një arsye për të mbështetur përgjigjen tuaj.

2 pikë

Prurjet më të mëdha janë shënuar në muajin_____

Arsyeja:_____

6. Në kolonën e djathtë jepen liqenet, ndërsa në kolonën e majtë origjina e formimit të tyre. Lidhni me shigjetë liqenin me origjinën e tij.

4 pikë

Liqenet e Dumresë

Tektonike

Liqeni i Shkodrës	Karstike
Liqeni i Fierzës	Lagunore
Liqeni i Butrintit	Artificiale
	Barazhi

Fotoja e mëposhtme tregon një nga problemet më shqetësuese në kushtet e degradimit të territorit dhe ndotjes së tokave.

7. Një nga faktorët kryesorë që ndikon në degradimin e tokave është:

- A) pjerrësia e vogël e shpateve.
- B) mbjellja e fidanëve të rinj.
- C) prerja e bimësisë.
- D) reshjet e pakta.



1 pikë

8. Degradimi i tokave ndodh **më tepër** në territoret e ndërtuara nga shkëmbinjtë:

- A) magmatikë
- B) metamorfikë
- C) terrigjenë
- D) gëlqerorë

1 pikë

9. Ekziston një shprehje lidhur me planetin ku jetojmë: “Tokën ne ua kemi marrë hua pasardhësve tanë”. Nxirrni dy ide të kësaj shprehjeje.


2 pikë

10. Numri i bashkive sipas ndarjes së fundit administrative në vendin tonë është:

1 pikë

- A) 59
- B) 60
- C) 61
- D) 62

Grafiku tregon ecurinë e numrit të popullsisë së Shqipërisë nga viti 1923 deri në vitin 2011.



11. Në cilën periudhë, popullsia e Shqipërisë ka pësuar rritje të ndjeshme?

1 pikë

- A) Nga viti 1923-1935
- B) Nga viti 1945-1990
- C) Nga viti 1980-2001
- D) Nga viti 2001-2011

12. Çfarë ka ndodhur me numrin e popullsisë pas vitit 1990. Jepni dy nga arsyet që kanë ndikuar.

3 pikë

Pas ndryshimeve të viteve 1990 dhe me rënien e sistemit të dikurshëm politik u mundësua lëvizja e lirë e popullsisë në Shqipëri. Referuar INSTAT për periudhën 2001-2011, mbi 112.000 individë u vendosën në qarkun e Tiranës, ndërkohë vitet e fundit shpesh keni dëgjuar se në Tiranë, në disa gjimnaze numri i nxënësve është shumë i madh. Referuar këtyre fakteve:


13. Shkruani një pasojë pozitive të migrimit të brendshëm të popullsisë:

1 pikë

14. Shkruani një pasojë negative të migrimit të brendshëm të popullsisë:

1 pikë

Grafikët e mëposhtëm paraqesin strukturën moshore të popullsisë së Shqipërisë në vite të ndryshme.



15. Vëzhgoni me kujdes të dy grafikët dhe përcaktoni **ndryshimin** që ka ndodhur në grupmoshën 0-15 vjeç, arsyen e këtij ndryshimi dhe një nga pasojat e tij. 3 pikë

Ndryshimi:

Arsyeja:

Pasoja:

16. Në periudha të caktuara historike, tiparet e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë kanë qenë të ndryshme. Identifikoni nga një tipar të përgjithshëm dallues të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë për periudhat e mëposhtme:

3 pikë

- Para viteve 1945
- Në vitet 1945-1990
- Pas viteve 1990

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-30

Arsimi i mesëm i lartë

(Klasat 10-12)

Klasa: 10-të

Përgatiti: Albana Zejnelhoxha, mësuese

Periudha e parë

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Konceptet	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit Nxënësi:	Niveli II i arritjes së kompetencave 40%	Niveli III i arritjes së kompetencave 40%	Niveli IV i arritjes së kompetencave 20%
Sistemi diellor Hëna si trup qiellor e satelit natyror i Tokës: Struktura Fazat e Hënës Hipotezat e formimit të saj.	4 pikë 13%	përshkruan Hënën dhe strukturën e saj; demonstron skematikisht varësinë (lidhjen) e fazave të Hënës nga pozicioni relativ i Diellit, Hënës dhe Tokës; sjell argumente në lidhje me hipotezat e formimit të Hënës; krahason eklipsin e Diellit dhe të Hënës;	1 pikë	1 pikë	2 pikë
Rrjeti gjeografik Projeksionet hartografike	7 pikë 24%	analizon ndërtimin e rrjetit gjeografik; shpjegon ndryshimin e kohës lokale dhe zonale përmes përlllogaritjeve të tyre	4 pikë	2 pikë	1 pikë

Hartat, elementët matematikorë dhe gjeografikë.		për vende me gjatësi të ndryshme gjeografike; diferencon llojet e ndryshme të projeksioneve hartografikë; analizon elementet matematikorë dhe gjeografikë të hartës dhe përdorimin e tyre; ndërton dhe interpreton profilin topografik të një sipërfaqeje të paraqitur në hartë;			
Atmosfera Përbërja e atmosferës dhe karakteristikat kryesore të secilës shtresë.	3 pikë 10%	analizon ndërtimin shtresor të atmosferës dhe përbërjen e saj;	2 pikë	1 pikë	-
Rrezatimi diellor dhe llojet e tij. Ndikimi i rrezatimeve në sistemet gjeofizike të Tokës.	6 pikë 20%	interpreton ndikimin e rrezatimeve (i drejtpërdrejtë, i shpërndarë, i përgjithshëm dhe i Tokës) në sistemet gjeofizike të Tokës; evidenton faktorët që ndikojnë në sasinë e rrezatimit që mbërrin në sipërfaqen e Tokës;	1 pikë	2 pikë	3 pikë
Temperatura e ajrit dhe ndryshimet e saj në kohë dhe në hapësirë.	6 pikë 20%	analizon ndryshimin në kohë të temperaturës (temperaturën mesatare ditore, mujore, vjetore, amplitudat) përmes llogaritjes dhe përpunimit të treguesve të temperaturës;	2 pikë	2 pikë	2 pikë

		analizon ndryshimin e temperaturës në hapësirë (horizontal dhe vertikal) dhe faktorët që ndikojnë në të;			
Erërat dhe llojet e tyre: erërat e qarkullimit të përgjithshëm dhe erërat lokale.	4 pikë 13%	shpjegon formimin e: - erërave të qarkullimit të përgjithshëm; - erërave lokale.	2 pikë	2 pikë	-

TEST


Për t'ju përgjigjur pyetjeve nga 1-5, referojuni figurave 1, 2, 3 dhe 4.

Figura nr. 1 tregon pozicionin e Tokës përkundrejt Diellit në një ditë të caktuar të vitit. Pikat nga A në E tregojnë disa vende në sipërfaqen e Tokës. Vija e pikëzuar tregon boshtin e Tokës.

Figura 2, 3 dhe 4 tregon mënyra të ndryshme të këndit të rënies së rrezeve të Diellit.

Figura 3 dhe 4 tregon shpërndarjen e rrezatimit diellor.

Fig. 1



1. Cila nga pjesët e figurës nr. 2 tregon në mënyrë të saktë këndin e rënies së rrezeve të Diellit në pikën C të figurës 1?

1 pikë

A) Pjesa A e figurës nr.2

B) Pjesa B e figurës nr.2

C) Pjesa C e figurës nr.2

D) Pjesa D e figurës nr.2

2. Nga figura 1 shohim që pikat B, C dhe E janë të gjitha të ndriçuara nga Dielli. Në cilën nga pikat është më nxehtë në atë ditë?

1 pikë

3. Argumentoni përgjigjen tuaj duke dhënë detaje nga figura 2, 3 dhe 4.

2 pikë


4. Në cilin nga paralelet dita është më e gjatë se nata? Jepni përgjigjen tuaj duke u bazuar në të dhënat e figurës 1.

1 pikë

5. Në cilin paralel Dielli **NUK** perëndon në atë ditë? Përgjigjen tuaj ilustroni me të dhëna nga figura 1.

1 pikë

6. Figura e mëposhtme paraqet pjesë të hartave topografike dhe profilin topografik. Lidhni me shigjetë hartën topografike me profilin topografik përkatës.



5 pikë

Për t'iu përgjigjur pyetjeve nga 7-9, referojuni figurës së mëposhtme e cila tregon shtresat e atmosferës së Tokës.



7. Në cilat shtresa të atmosferës së Tokës fluturojnë avionët që përdoren për transportin e pasagjerëve?

1 pikë

- A) Nga troposferë deri në ekzosferë.
- B) Nga troposfera deri në termosferë.
- C) Në troposferë dhe stratosferë.
- D) Në troposferë, stratosferë dhe mezosferë.

8. Pse është shumë e rëndësishme shtresa e stratosferës për jetën në Tokë?

1 pikë

- A) Në stratosferë mund të fluturojnë avionët dhe anijet kozmike, për shkak të dendësisë së ulët të ajrit.

- B) Stratosfera e mbron Tokën nga rrezet ultravjollcë, sepse aty gjendet shtresa e ozonit.
- C) Në stratosferë ndodhin të gjitha proceset meteorologjike si formimi i reve, reshjeve etj.
- D) Stratosfera e mbron Tokën nga meteorët, sepse aty ndodh djegia e tyre.

9. Në cilën shtresë të atmosferës ndodhin agimet polare?

1 pikë

- A) Troposferë
- B) Stratosferë
- C) Ozoznosferë
- D) Jonosferë

Për t'iu përgjigjur pyetjeve nga 10-11 referojuni tabelës së mëposhtme.

Tabela tregon matjet e temperaturës gjatë ditës në dy stacione të ndryshme.

Stacioni	Temperatura e matur në orën 7:00	Temperatura e matur në orën 14.00	Temperatura e matur në orën 21.00	Temperatura që tregon termometri maksimal	Temperatura që tregon termometri minimal
Tiranë	10°C	18°C	12°C	18°C	4.5°C
Shkodër	8°C	16°C	7°C	16°C	3.5°C

10. Sa është temperatura mesatare ditore në stacionin e Tiranës?

1 pikë

- A) 13.5°C
- B) 13°C
- C) 12.5°C
- D) 12°C

11. Sa është amplituda ditore e temperaturës në stacionin e Shkodrës?

1 pikë

- A) 20°C
- B) 18°C
- C) 16.5°C
- D) 12.5°C

12. Në troposferë, temperatura e ajrit të thatë, me rritjen e lartësisë ulet mesatarisht 1°C për 100m lartësi, ndërsa temperatura e ajrit të lagët ulet 0.6°C për 100m. Shpjegoni pse ndodh ky ndryshim midis ajrit të thatë dhe ajrit të lagët?

1 pikë

13. Siç e përmendëm në pyetjen 11, në troposferë, temperatura e ajrit ulet me rritjen e lartësisë. Por në raste të veçanta mund të ndodhë që në shtresa më të larta, temperatura e ajrit të jetë më e lartë se në shtresa të ulëta. Si quhet ky fenomen dhe shpjegoni përse ndodh?

3 pikë

Ky fenomen quhet: _____

Shpjegimi:

Më poshtë është paraqitur harta e botës, e cila është ndërtuar sipas një projeksoni të caktuar. Ju e dini që projeksonet hartografike janë të ndryshme. Secili prej tyre ka një rrjet hartografik të veçantë. Bazuar në rrjetin hartografik të hartës së mëposhtme, përgjigjuni pyetjeve nga 14 – 16.




14. Si quhet lloji i projeksionit hartografik të përdorur? Si paraqiten meridianët dhe paralelet në këtë lloj projeksioni? **2 pikë**

15. Si formohet ky lloj projeksioni? **1 pikë**

16. Cila është e meta e këtij lloj projeksioni? Ilustrojeni përgjigjen tuaj me një shembull konkret nga harta e mësipërme. **2 pikë**


17. Shkronja U në hartën përbri tregon një zonë me:

- A) trysni atmosferike të ulët.
- B) temperaturë të ulët.
- C) reshje të pakta.
- D) lartësi të ulët.



1 pikë

Figurat e mëposhtme paraqesin formimin e puhisë detare dhe puhisë tokësore, të cilat formohen në zona bregdetare.



18. Në cilat lloj erërash bën pjesë puhia (briza)?

1 pikë

- A) Erërat e qarkullimit të përgjithshëm
- B) Erërat lindore të gjerësive polare
- C) Erërat ciklonike
- D) Erërat lokale

19. Sa herë e ndryshon drejtimin puhia (briza)?

1 pikë

- A) Dy herë gjatë stinës së dimrit
- B) Dy herë gjatë stinës së verës

C) Dy herë brenda 24 orëve

D) Dy herë brenda 12 orëve

20. Bazuar në figurë shpjegoni se si formohet puhia detare.

2 pikë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-30

Klasa: 11-të

Përgatiti: Majlinda Ziu, mësuese

Periudha e dytë

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Konceptet	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit Nxënësi:	Niveli II i arritjes së kompetencave 40%	Niveli III i arritjes së kompetencave 40%	Niveli IV i arritjes së kompetencave 20%
Popullsia dhe vendbanimet. Tiparet e zhvillimit të përgjithshëm demografik. Migrimet e popullsisë dhe roli i veçantë i tyre në zhvillimet demografike të vendit.	12 pikë 34 %	interpretton ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve; analizon procesin e migrimit si promotorin e të gjitha ndryshimeve demografike të popullsisë shqiptare, duke u ndalur në periudhën pas vitit 1990;	4 pikë	6 pikë	2 pikë
Vlerësim i potencialeve natyrore dhe humane të vendit për zhvillimin e tij ekonomik.	6 pikë 17 %	vlerëson potencialet natyrore dhe humane të Shqipërisë dhe ndikimin e tyre në shkallën e zhvillimit ekonomik të vendit;	3 pikë	-	3 pikë
Veçoritë kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor dhe	17 pikë 49 %	përshkruan veçoritë kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor dhe potencialet natyrore për zhvillim; vlerëson zhvillimin bujqësor, industrial, të tregtisë, turizmit,	7 pikë	8 pikë	2 pikë

<p>vlerësimi i tyre për zhvillimin e rajonit.</p> <p>Tiparet e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor dhe ecuria e këtij zhvillimi në periudha të ndryshme.</p> <p>Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Perëndimor.</p>		<p>transportit etj., të Rajonit Perëndimor;</p> <p>vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Perëndimor dhe rëndësinë e saj;</p>			
--	--	--	--	--	--

TEST

Qarkoni alternativën e duhur.

1. Fusha me sipërfaqen më të madhe në vendin tonë është:

1 pikë

- A) fusha e Mbishkodrës
- B) fusha e Nënshkodrës
- C) fusha e Myzeqesë
- D) fusha e Elbasanit

2. Në përbërjen gjeologjike të truallit të Rajonit Perëndimor mbizotërojnë:

1 pikë

- A) shkëmbinjtë magmatikë bazikë
- B) shkëmbinjtë magmatikë acidë
- C) shkëmbinjtë sedimentarë
- D) shkëmbinjtë metamorfikë

3. Vendi ynë përgjatë kohërave, por në mënyrë të veçantë pas viteve '90, ka pësuar ndryshime të mëdha demografike, të cilat në një masë të madhe janë ndikuar nga migrimet e popullsisë. Përcaktoni kuptimin tuaj mbi konceptin migrim. Përmes shembujve ilustrues, evidentoni tre prej faktorëve kryesorë që kanë ndikuar në këtë fenomen social në vendin tonë.

4 pikë

4. Plotësoni në vendet bosh për secilën prej fotove të mëposhtme: a) llojin e vendbanimit shqiptar; b) një nga veçoritë kryesore të secilit prej vendbanimeve referuar periudhës kohore së cilës i përket.

6 pikë



1. _____

2. _____

3. _____

5. Bazuar në hartën e Shqipërisë:

a) Identifikoni tre ndër potencialet natyrore të vendit tonë. **3 pikë**

b) Vlerësoni rolin e tyre për zhvillimin ekonomik të vendit tonë. **3 pikë**



6. Divjaka është një qytet në Shqipëri që ndodhet pesë km larg Detit Adriatik dhe në verilindje të Lagunës së Karavastasë, me rreth 7 282 banorë. Ajo është një ndër destinacionet turistike më tërheqëse të vendit tonë.
- a) Në hartën e mësipërme të Shqipërisë, emërtoni dhe qarkoni rajonin gjeografik në të cilin bën pjesë Divjaka. **2 pikë**
- b) Përcaktoni tre ndër tiparet fizike të këtij rajoni. **3 pikë**
- c) Jepni dy argumente pse fauna dhe flora në zonën e Divjakës konsiderohet e larmishme. **2 pikë**
- d) Përshkruani dy mundësi zhvillimi të ekonomisë në zonën e Divjakës. **2 pikë**
7. Një bashkëmoshatar i juaji, nënshtetas joshqiptar, dëshiron të vijë në Shqipëri dhe të kalojë disa ditë pushimi në Rajonin Perëndimor të Shqipërisë. Ai kërkon nga ju që ta orientoni atë dhe ta njihni me 2 nga zonat/vendet kryesore të trashëgimisë natyrore e kulturore që do të duhet të vizitohet. Për këtë, ju ndërtoni një tabelë si më poshtë, ku paraqiten zonat/vendet kryesore që ai do të duhet të vizitohet, duke e argumentuar se pse e vlerëson si mundësi shumë të mirë për ta vizituar. **6 pikë**

Zona/Vendi që duhet të vizitohet	Një përshkrim i shkurtër për vendndodhjen gjeografike (lokacion relativ)	Pse duhet të vizitohet (vlera/ rëndësia që ka)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-8	9-13	14-18	19-23	24-27	28-31	32-35

Klasa: 11-të

Përgatiti: Majlinda Ziu, mësuese

Periudha e tretë

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Konceptet	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit Nxënësi:	Niveli II i arritjes së kompetencave 40%	Niveli III i arritjes së kompetencave 40%	Niveli IV i arritjes së kompetencave 20%
Rajoni Verior-Verilindor: veçoritë kryesore natyrore dhe potencialet e shumta natyrore për zhvillimin e tij. Pjesët përbërëse të Rajonit Verior - Verilindor dhe specifikat e tyre rajonale. Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Verior – Verilindor. Tipare të zhvillimit ekonomik të Rajonit Verior – Verilindor. Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Verior – Verilindor.	13pikë 37%	përshkruan mozaikun natyror të Rajonit Verior - Verilindor dhe potencialet natyrore për zhvillim; identifikon tiparet e përgjithshme natyrore të pjesëve përbërëse të Rajonit Verior – Verilindor; evidenton tiparet kryesore të zhvillimit demografik të Rajonit Verior – Verilindor; analizon tiparet kryesore të aktivitetit aktual ekonomik të Rajonit Verior – Verilindor, vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Verior – Verilindor;	3 pikë	4 pikë	6 pikë

<p>Rajoni Juglindor: pozicioni gjeografik dhe tiparet dalluese natyrore. Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Juglindor. Potencialet dhe gjendja e zhvillimit ekonomik të Rajonit Juglindor.</p>	<p>6 pikë 17%</p>	<p>vlerëson pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal; përshkruan tiparet dalluese natyrore të Rajonit Juglindor; analizon tiparet dalluese dhe tendencën e zhvillimit demografik të Rajonit Juglindor; analizon tiparet kryesore të veprimtarisë ekonomike të Rajonit Juglindor;</p>	<p>1 pikë</p>	<p>5 pikë</p>	<p>-</p>
<p>Rajoni Jugor: tiparet e përgjithshme natyrore që dallojnë rajonin. Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Jugor (numri i popullsisë, shpërndarja e saj, struktura etj.). Migrimet e popullsisë dhe pasojat e tyre në zhvillimet rajonale. Struktura e zhvillimit ekonomik të Rajonit Jugor dhe pasojat ndërrajonale të saj. Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Jugor.</p>	<p>16 pikë 46%</p>	<p>vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike ndërkufitare të Rajonit Jugor për zhvillimet rajonale; përshkruan tiparet e përgjithshme natyrore që dallojnë Rajonin Jugor; analizon tiparet dalluese të zhvillimit demografik të Rajonit Jugor; evidenton pasojat e migrimeve të popullsisë së Rajonit Jugor; dallon tiparet kryesore të veprimtarisë ekonomike të Rajonit Jugor dhe pasojat ndërrajonale të saj; vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor dhe rëndësinë e saj; identifikon mundësitë dhe argumenton perspektivën e zhvillimit të Rajonit Jugor.</p>	<p>9 pikë</p>	<p>5 pikë</p>	<p>2 pikë</p>

TEST

Qarkoni alternativën e duhur.

1. Grumbulli më i madh kodrinor i vendit ndodhet në:

1 pikë

- A) Rajonin Perëndimor
- B) Rajonin Lindor
- C) Rajonin Verior
- D) Rajonin Jugor

2. Në përbërjen gjeologjike të truallit të Alpeve Shqiptare mbizotërojnë:

1 pikë

- A) Shkëmbinjtë magmatikë bazikë
- B) Shkëmbinjtë magmatikë acidë
- C) Shkëmbinjtë metamorfikë
- D) Shkëmbinjtë gëlqerorë

3. Liqene me origjinë karstike në Shqipëri i gjejmë në:

1 pikë

- A) Ultësirën e Shkodrës
- B) Malet e Lurës
- C) Pllajën e Dumresë

D) Bllokun e Jezercës

4. Vlerësoni rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Juglindor dhe ndikimin e saj:

3 pikë

a) Në klimën e rajonit

b) Në popullimin e rajonit

c) Në zhvillimin ekonomik të rajonit

5. Në figurën e mëposhtme, numrat brenda rrethëve u takojnë njësive fiziko-gjeografike përbërëse të Rajonit Jugor. Referuar numrave, përcaktoni secilën nga njësitë përbërëse të këtij rajoni.

8 pikë



6. Thethi është një fshat në njësinë administrative Shalë të rrethit të Shkodrës. Pas reformës së qeverisjes lokale të vitit 2015, ai u bë pjesë e rrethit Shkodër dhe u shpall Qendër e Mbrojtur Historike nga Qeveria Shqiptare. Fshati është qendra e Parkut Kombëtar të Thethit, një zonë me bukuri natyrore të dalluara.



- a) Në hartën e Shqipërisë, emërtoni dhe qarkoni rajonin gjeografik në të cilin bën pjesë Thethi. **2 pikë**
- b) Përcaktoni tre ndër tiparet fizike të këtij rajoni. **3 pikë**
- c) Jepni dy argumente pse dendësia e popullsisë në këtë zonë është e ulët. **2 pikë**
- d) Përshkruani dy mundësi zhvillimi të ekonomisë në zonën e Thethit. **2 pikë**
- 7.** Qarkoni V nëse pohimi është i vërtetë ose G nëse pohimi është i gabuar. **4 pikë**
- a) Nënrajonin Verior shtrihet në jug të lumit Drin. V / G
- b) Mali i Nemërçkës është më i larti i Rajonit Juglindor. V / G
- c) Lumi Drinos formohet si bashkim i Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi. V / G
- d) Palafitet e hershme të paraardhësve tanë janë zbuluar në Tren e Maliq. V / G

8. Në vitin 1898 u ra në gjurmë të një varreze të madhe, pranë Kalasë së Dalmaces, në fshatin Koman të Pukës. Në vazhdim u zbulua një numër i madh varrezash të ngjashme, rreth 30, të përhapura kryesisht në Shqipërinë e Veriut e në atë të Mesme. Shpërndarja gjeografike, tipologjia, inventari dhe kronologjia e njëjtë e këtyre varrezave i ka shtyrë studiuesit të identifikojnë në to kulturën e hershme mesjetare shqiptare, të quajtur "Kultura e Komanit" (shek. VI-VIII). Në vitet e fundit zbulime të "Kulturës së Komanit" janë bërë edhe në Shqipërinë e Jugut si dhe përtej kufijve shtetërorë, në Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni e në Greqi.

Përshkruani dy prej treguesve që e karakterizojnë “ Kulturën e Komanit”.

2 pikë

9. Një bashkëmoshatar i juaji, nënshtetas joshqiptar, dëshiron të vijë në Shqipëri dhe kalojë disa ditë pushimi në Rajonin Jugor të Shqipërisë. Ai kërkon nga ju që ta orientoni atë dhe ta njihni me 2 nga zonat/vendet kryesore të trashëgimisë natyrore e kulturore që do të duhet të vizitohet. Për këtë, ju ndërtoni një tabelë, si më poshtë, ku paraqiten zonat/vendet kryesore që ai do të duhet të vizitohet, duke e argumentuar se pse e vlerëson si mundësi shumë të mirë për ta vizituar.

6 pikë

Zona/Vendi që duhet të vizitohet	Një përshkrim i shkurtër për vendndodhjen gjeografike (lokacion relativ)	Pse duhet të vizitohet (vlera/ rëndësia që ka)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-8	9-13	14-18	19-23	24-27	28-31	32-35

Klasa: 12-të

Përgatiti: Albana Zejnelhoxha, mësuese

Periudha e parë

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Konceptet	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit Nxënësi.	Niveli II i arritjes së kompetencave 40%	Niveli III i arritjes së kompetencave 40%	Niveli IV i arritjes së kompetencave 20%
Temat bazë të studimeve në gjeografinë e sotme bashkëkohore.	3 pikë 10%	analizon temat bazë në gjeografi: vendndodhja, vendi, rajoni, lëvizja, marrëdhëniet njeri-mjedis dhe proceset hapësinore;	3 pikë	-	-
Bashkimi Evropian dhe perspektiva të zhvillimit.	2 pikë 7%	interpretin historikun dhe karakteristikat e formimit, zhvillimit e zgjerimit të BE-së;	1 pikë	1 pikë	-
Nënrajonet kryesore të Evropës: Evropa Perëndimore, Evropa Qendrore, Evropa Veriore, Evropa Ishullore, Evropa Mesdhetare, Evropa Lindore. Tiparet natyrore të secilit nënrajon.	12 pikë 40%	identifikon nënrajonet kryesore të Evropës; interpretin për secilin nënrajon tiparet kryesore natyrore;	1 pikë	7 pikë	4 pikë
Tiparet e përgjithshme natyrore të Rusisë:	6 pikë 20%	identifikon veçoritë specifike rajonale natyrore të Rusisë;	2 pikë	2 pikë	2 pikë

<ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. 					
<p>Veçoritë natyrore kryesore të rajonit të Amerikës së Veriut:</p> <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. 	4 pikë 10 %	<p>përshkruan tiparet kryesore natyrore të rajonit të Amerikës së Veriut:</p> <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë; 	3 pikë	-	-
<p>Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Amerikën e Veriut.</p>	3 pikë 10%	<p>vlerëson shkallën e urbanizimit të Amerikës Veriore dhe perspektivën e zhvillimit;</p>	2 pikë	1 pikë	-

<p>Modelet ekonomike të zhvillimit të Amerikës së Veriut.</p>	<p>1 pikë 3%</p>	<p>analizon tipet dhe llojet e ndryshme të rajoneve të ShBA-së dhe të Kanadasë, si dhe modelet e tyre të zhvillimit, duke evidentuar modelin ekonomik të zhvillimit të ShBA-së.</p>	<p>-</p>	<p>1 pikë</p>	<p>-</p>
---	----------------------	---	----------	---------------	----------

TEST

Në gjeografi përdoren 5 tema apo koncepte gjeografike për të analizuar modelet hapësinore. Përgjigjuni pyetjeve nga 1-3 në lidhje me 5 temat bazë në gjeografi.

1. Dikush ju thotë se banon te pallati ngjitur me zyrën postare. Në këtë mënyrë është shprehur:

1 pikë

- A) Vendndodhja absolute
- B) Vendndodhja relative
- C) Distanca
- D) Arritshmëria

2. Vendndodhja e saktë e një vendi përcaktohet duke përdorur:

1 pikë

- A) Gjatësinë gjeografike
- B) Gjerësinë gjeografike
- C) Koordinatat gjeografike
- D) Karakteristikat gjeografike

3. Japonia shet makina në SHBA, vetë SHBA eksporton teknologjinë e lartë në Arabinë Saudite dhe Arabia Saudite eksporton naftë në Japoni. Cila nga temat bazë të gjeografisë është shprehur?

1 pikë

- A) Distanca

- B) Ndërvarësia
 - C) Vendndodhja
 - D) Hapësira
-

Pavarësisht problemeve dhe sfidave të ditëve të sotme, prirja e vazhdueshme e BE-së ka qenë dhe është zgjerimi dhe fuqizimi i tij. Përgjigjuni pyetjeve nga 4-5, që kanë të bëjnë me Bashkimin Evropian.

4. “Babai” i Evropës së Bashkuar është francezi Zhan Mone. Qëllimi themelor i planit të tij ishte:

1 pikë

- A) Mbrojtja e Evropës nga luftërat e mundshme
- B) Mbrojtja e Evropës Perëndimore nga rreziku i kolonizimit
- C) Vendosja e marrëdhënieve midis Evropës dhe Amerikës
- D) Rimëkëmbja ekonomike e Evropës si lider botëror

5. Monedha e përbashkët evropiane (Euro) u hodh në qarkullim në vitin:

1 pikë

- A) 2000
- B) 2001
- C) 2002
- D) 2003

Relievi malor në Evropë është formuar në periudha të ndryshme gjeologjike. Si rezultat dallojmë sisteme malore të rrudhosjeve të reja dhe male të vjetra, me përbërje gjeologjike dhe pamje të ndryshme. Mbështetur në këto fakte, përgjigjuni pyetjeve:

6. Përcaktoni për rajonet e dhëna moshën e maleve dhe fizionominë (pamjen) e tyre:

4 pikë

Rajoni	Rajoni i Evropës Jugore (Mesdhetare)	Rajoni i Evropës Perëndimore
Mosha		
Pamja		

Duke iu referuar hartës së mëposhtme, përgjigjuni pyetjeve nga 7-11.

7. Cilin rajon të Evropës tregon harta e dhënë?

- A) Rajonin Perëndimor
- B) Rajonin Verilindor



1 pikë

C) Rajonin Verior

D) Rajonin Lindor

8. Vendosni në hartë shkronjat që i korrespondojnë elementeve gjeografike të mëposhtme.

4 pikë

Me shkronjën A shënoni ngushticën Kategat

Me shkronjën B shënoni Detin e Veriut

Me shkronjën C shënoni Gadishullin e Jutlandës

Me shkronjën D shënoni Gjirin Botnik



1 pikë

9. Cili nga shtetet e rajonit dallohet për brigje të larta shkëmbore dhe fjorde?

A) Danimarka

B) Suedia

C) Norvegjia

D) Islanda

10. Cili shtetet dallohet për numrin e konsiderueshëm të vullkaneve aktivë dhe të gejzerëve?

1 pikë

A) Danimarka

B) Suedia

C) Norvegjia

D) Islanda

11. Cili nga shtetet e mëposhtme të Evropës Veriore dallohet për numrin e lartë të liqeneve?

1 pikë


A) Norvegjia

B) Suedia

C) Finlanda

D) Danimarka

Harta e mëposhtme tregon vendndodhjen e qytetit Murmansk në Federatën Ruse, i cili shtrihet në ekstremin veriperëndimor të Ruisë evropiane. Ai është një qytet port jo shumë larg nga kufiri i Ruisë me Norvegjinë. Qyteti përfaqëson një bazë detare të rëndësishme. Edhe pse ky qytet shtrihet në Rrethin Polar të Veriut, gjatë gjithë vitit është i lirë nga akujt, duke mundësuar qarkullimin detar.




12. Cila është arsyeja që ky port nuk bllokohet nga akujt gjatë gjithë vitit edhe pse ndodhet në Rrethin Polar të Veriut? **1 pikë**
13. Sa orë zgjat dita në këtë port gjatë muajve të verës? Pse? **1 pikë**
14. Klima e makrorajonit Rus në përgjithësi është e ftohtë dhe me karakter mbizotërues kontinental. Përcaktoni dy nga faktorët që ndikojnë në këto tipare të klimës së këtij rajoni. **2 pikë**

Në makrorajonin Rus zonat klimatike kanë një shtrirje nga zona e klimës polare në veri deri në atë subtropikale në jug. Në këto kushte dhe bimësia e rajonit shfaqet e larmishme. Renditni dy nga përfaqësuesit bimorë të këtij makrorajoni. **2 pikë**

Për t'ju përgjigjur pyetjeve nga 15-19, referojuni hartës së mëposhtme.

SHBA dhe Kanada



- 15.** Numri **4** në hartën e dhënë tregon: **1 pikë**
- A) lumin Shën Lorenc.
 B) lumin Rio Grande.
 C) lumin Kolorado.
 D) lumin Kolumbia.
- 16.** Numri **1** në hartë tregon Liqenet e Mëdha. Emërtoni dy prej tyre. **2 pikë**
- 17.** Pjesa me ngjyrë jeshile në hartë, tregon një nga megalopolet më të mëdha të Amerikës Veriore. Çfarë kuptoni me termin “megalopol”? **1 pikë**
- 18.** Shkruani dy nga qytetet kryesore të këtij megalopoli. **2 pikë**
- 19.** Numri 2 në hartë tregon “Rajonin Jugor” të SHBA-së në kuadër të rajonizimit ekonomik të saj. Cili sektor i ekonomisë është më i zhvilluar në këtë rajon? **1 pikë**

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-30

Klasa: 12-të

Përgatiti: Albana Zejnelhoxha, mësuese

Periudha e dytë


Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Konceptet	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit Nxënësi:	Niveli II i arritjes së kompetencave 40%	Niveli III i arritjes së kompetencave 40%	Niveli IV i arritjes së kompetencave 20%
Karakteristikat humane të rajonit të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore: - popullsia dhe veçoritë e saj; - kompleksiteti kulturor dhe politik i rajonit. Tendenca të zhvillimeve rajonale të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore.	6 pikë 20%	analizon problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore, si dhe perspektivën e tyre;	4 pikë	2 pikë	-
Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Afrikës Nënahariane.	6 pikë 20%	përshkruan tiparet fiziko-gjeografike të Afrikës Nënahariane;	-	4 pikë	2 pikë
Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Azisë Jugore, Azisë Juglindore, Azisë lindore.	9 pikë 30%	përshkruan tiparet fiziko-gjeografike të Azisë Jugore, Azisë Juglindore, Azisë lindore;	5 pikë	4 pikë	-

Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Australisë.	2 pikë 7%	përshkruan tiparet fiziko-gjeografike të Australisë;	2 pikë	-	-
<ul style="list-style-type: none"> - Tendencat e sotme të popullsisë në botë; - ndryshimet e numrit të popullsisë dhe shpërndarja gjeografike në botë; - mbipopullimi dhe presioni demografik mbi territorin; - struktura e popullsisë (moshore, gjinore, sociale, profesionale). 	7 pikë 23%	identifikon tendencat e ndryshimit të numrit të popullsisë në botë dhe shpërndarjes gjeografike të saj; analizon rritjen e popullsisë në vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim, faktorët që ndikojnë në këtë rritje dhe shpërndarjen e popullsisë.	-	3 pikë	4 pikë

TEST


Shpesh keni dëgjuar për “choke points” ose kalime strategjike në disa nga rajonet e botës.



1. Duke u mbështetur në hartën e dhënë, shpjegoni çfarë përfaqësojnë këto kalime. **1 pikë**
2. Identifikoni në hartë tri nga “choke points”, kalimet strategjike më të njohura në rajonin e Afrikës Veriore e Azisë Jugperëndimore: **3 pikë**
3. Rajoni i Afrikës Veriore-Azisë Jugperëndimore kohët e fundit po përballlet me shqetësime të ndryshme gjeopolitike. Identifikoni dy nga shqetësimet e sotme gjeopolitike të rajonit të Afrikës Veriore - Azisë Jugperëndimore. **2 pikë**

4. Harta tregon vendndodhjen e liqenit Çad, në rajonin e Afrikës Nënsahariane. Një nga veçoritë hidrologjike të liqenit Çad është lëkundja e theksuar e nivelit të liqenit gjatë vitit.

Shpjegoni pse ndodh kjo lëkundje e niveleve të liqenit Çad.



2 pikë

5. Vendosni në hartën e dhënë shkronjat që i korrespondojnë elementeve gjeografike të mëposhtëm:

Me shkronjën A shënoni rrjedhën e lumit Kongo

Me shkronjën B shënoni Gadishullin e Somalisë

Me shkronjën C shënoni rrjedhën e lumit Nil

Me shkronjën D shënoni Detin e Kuq



4 pikë

Harta tregon rajonet e Azisë Jugore, Lindore e Juglindore. Përgjigjuni pyetjeve nga 6-9 në lidhje me këto rajone.

6. Vendosni në hartë shkronjat që i korrespondojnë elementeve gjeografikë të mëposhtëm:

5 pikë

Me shkronjën A shënoni Gadishullin Korean

Me shkronjën B shënoni gadishullin e Malakës

Me shkronjën D shënoni rrjedhën e lumit Ind

Me shkronjën E shënoni ishujt Filipine



7. Ishulli më i populluar në Azinë Juglindore është:

1 pikë

A) Borneo

B) Filipine

C) Java

D) Sumatra

8. Në cilin rajon aziatik është regjistruar sasia më e madhe e reshjeve në botë?

1 pikë

A) Azinë Qendrore

- B) Azinë Lindore
- C) Azinë Jugore
- D) Azinë Juglindore

9. Japonia dallohet për shkallë të lartë të punësimit “urban-industrial”. Shkruani të paktën dy faktorë që kanë ndikuar në shkallën e lartë të urbanizimit. **2 pikë**

Kanguri përfaqëson faunën e lashtë dhe endemike të kontinentit australian.

10. Shpjegoni pse kanguri, flora dhe fauna e kontinentit Australian janë origjinale dhe endemike? **1 pikë**





11. Pse Australia dallohet për një rrjet lumor të varfër dhe pak të zhvilluar? **1 pikë**

Për t'iu përgjigjur pyetjeve 12 dhe 13 referojuni piramidave të popullsisë A dhe B.

12. Vëzhgoni me kujdes piramidën A dhe nxirrni tri karakteristika të saj, në lidhje me:

3 pikë

- a) Numrin e lindjeve
- b) Moshën e tretë
- c) Karakteristikë e kujt vendeve është kjo piramidë



13. Piramida B nuk ngjan aspak me një piramide normale popullsie. Ajo paraqet piramidën e popullsisë për vitin 2011 në Emiratet e Bashkuara Arabe. Bazuar në të dhënat e piramidës B, nxirrni një arsye që mund të ketë ndikuar në krijimin e një piramide të tillë popullsie.

2 pikë

14. Si ndahet struktura moshore e popullsisë nëse duam të analizojmë aftësinë e njerëzve për të punuar?

3 pikë

- a) Grupmosha nën moshën e punës (0-14 vjeç)
- b) Grupmosha në moshën e punës (15-65 vjeç)
- c) Grupmosha mbi moshën e punës (mbi 65 vjeç)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-30